



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.280/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në rrugën “Armend Daci” nr.1, në Prishtinë, kundër debitorit “Abi-Likaj” SH.P.K., me NUI:810970609, me seli në Krajë, Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Muhamet Shalaj., avokat në Prizren, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.648/23 të datës 10.08.2023, me datën 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Abi-Likaj” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.648/23 të datës 10.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.648/23 të datës 10.08.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Abi-Likaj” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.18/2023 të datës 23.01.2023, të Përmbaruesit Privat Mehdi S. Reshani. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.18/2023 i datës 23.01.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Mehdi S. Reshani.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.648/23 të datës 10.08.2023.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 23.01.2023 ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbaremore – Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.3674, të datës 08.10.2021, me të cilën është urdhëruar debitori që t'ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 10,997.50€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore nën kërcënimin e përmbaremit të dhunshëm,

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se aktvendimi i marr nga KPMM-ja me të cilin i është shqiptuar gjoja debitorit, është vendim i pabazuar në prova dhe fakte dhe i dhënë në mënyrë arbitrare. Tutje ka shtuar se, gjatë shqiptimit të gjobës është bërë konstatim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sepse në procesverbalin e bërë gjatë shqiptimit të gjobës nuk është provuar asnjëherë se debitori ka kryer aktivitete minerare të jashtëligjshme. Ka deklaruar se, bëhet fjalë për dokument përmbaremore i cili nuk është titull ekzekutiv dhe dokumentet e bashkangjitura propozimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbaremit dhe janë në kundërshtim me LPP-në.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit se Aktvendimi i marrë nga KPMM-ja është i pabazuar në prova dhe fakte, për arsye se ky pretendim nuk është objekt i procedurës përmbaremore ngase debitori nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij të ankesës që ta kontestoj vlefshmërinë e aktit administrativ në procedurë administrative. Tutje ka shtuar se, vendimi është bërë i formës së prerë me datë 19.11.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.12.2021, pasi që debitori nuk e ka kryer pagesën brenda afatit të paraparë ligjor. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbaremore P.nr.18/2023 i datës 23.01.2023 dhe të obligohet debitori që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.648/23 të datës 10.08.2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Abi-Likaj” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.18/2023 të datës 23.01.2023, të Përmbaremit Privat Mehdi S. Reshani. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrit Përmbaremore P.nr.18/2023 i datës 23.01.2023, i lejuar nga Përmbaremit Privat Mehdi S. Reshani.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se aktvendimi nr.3674 i datës 08.10.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së,

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi nr.3674 i datës 08.10.2021, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është ne pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 te LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se aktvendimi nr.3674 i datës 08.10.2021, është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është bërë i formës së prerë me datë 19.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 05.12.2021, ashtu qe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri*”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim.

Gjykata e shkallës së dytë vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit të parashtruara në ankesë, mirëpo nuk u lëshua në vlerësimin e të tyre pasi që palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre, ndërsa dokumenti përmbartimor në fjalë në këtë fazë, është i përshtatshëm për përmbartim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së pare.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.280/24 me datë 07.06.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**